

Programi IPA i Bashkimit Evropian për Kosovë

Projekti

**MBËSHTETJA PËR ZBATIMIN E PAKOS SE 3-të TË ENERGJISË
ME FOKUS NË EFIÇIENCËN E ENERGJISË DHE BURIMET E
RIPËRTRITSHME**

KOMUNA E HANI I ELEZIT

**Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e
Energjisë (PKVEE)**

2019– 2021



Projekt i financuar nga Bashkimi
Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra e
BE-se ne Kosove

Implementuar nga
GFA Consulting Group GmbH

Ne konsorcium me Exergia S.A dhe AF Mercados

Mars 2019

Komuna e Hani i Elezit



Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE)

2019 – 2021

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencë të Energjisë për Komunën e Hani i Elezit është përgatitur me mbështetjen e projektit të financuar nga BE-ja "Mbështetja për Zbatimin e Pakos së 3-të të Energjisë me fokus në Eficiencën e Energjisë dhe Burimet e Ripërtëritshme"

Përgatitur nga:

Arjan Visser, Eksperti kryesor i 2-të - "Mbështetja për Zbatimin e Pakos së 3-të të Energjisë me fokus në Efikasitetin Energjetik dhe Burimet e Ripërtëritshme"

Mbledhja e të dhënave:

Kujtim Asllani, Eksperti Afatshkurtër - " Mbështetja për Zbatimin e Pakos së 3-të të Energjisë me fokus në Efikasitetin Energjetik dhe Burimet e Ripërtëritshme"

Kujtim Dernjani, Zyrtari Komunal për Energji – Komuna e Hani i Elezit

Përmbajtja

1.	HYRJE	7
1.1	KONTEKSTI.....	7
1.2	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	8
2.	INFORMACIONET BAZË PËR KOMUNËN.....	10
2.1	POPULLSIA DHE VENDBANIMET	10
2.2	STRUKTURA ORGANIZATIVE	11
2.3	TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR	12
2.4	PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE PËR EE TË ZBATUARA NË KOMUNË.....	13
3.	ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE.....	13
3.1	KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE.....	14
3.2	SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK TE RRUGËVE	16
3.3	KOMPANITË PËR SHËRBIME KOMUNALE	17
3.4	TRANSPORTI PUBLIK / PARKU I ATUMOJETEVE TË KOMUNËS.....	17
4.	PRODHIMI I ENERGJISË NGROHËSE PËR NDËRTESAT PUBLIKE KOMUNALE	18
5.	ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIKASITETIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE	18
5.1	SEKTORI I NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE.....	18
5.2	SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK TË RRUGËVE	24
5.3	POTENCIALI I PËRGJITHSHËM I KURSIMIT TË ENERGJISË	24
6.	PLANI I VEPRIMIT.....	25
6.1	PROJEKTET INVESTIVE ME PRIORITET KOMUNAL	25
6.2	HAPAT ARDHSHËM	25
7.	KORNIZA E FINANCIMIT.....	26
7.1	PLANIFIKIMET BUXHETORE	26
7.2	FONDI I KOSOVËS PËR EFIÇIENCË TË ENERGJISË (FKEE).....	26
8.	MONITORIMI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT	27
	SHTOJCA 1 – METODOLOGJIA DHE ARSYETIMI.....	28
	SHTOJCA 2 – BURIMI I TË DHËNAVE KOMUNALE.....	32
	SHTOJCA 3 - PJESË NGA BUXHETI KOMBËTAR RELEVANTE ME HANIN E ELEZIT DHE EFIÇIENCËN E ENERGJISË	36

Tabelat

Tabela 1: Pasqyra e potencialit te kursimeve te energjisë në Komunën e Hani i Elezit.....	9
Tabela 2: Lista e projekteve për investimet prioritare.....	10
Tabela 3: Zonat e populluara të komunës së Hani i Elezit (2015).....	10
Tabela 4: Buxheti i Komunës së Hani i Elezit (Euro).....	12
Tabela 5: Projektet e EE te zbatuara në 3 vitet e fundit në Komunën e Hani i Elezit	13
Tabela 6: Pasqyra e ndërtesave të përjashtuara nga analiza e mëtutjeshme	15
Tabela 7: Konsumi i karburanteve për parkun e automjeteve të komunës (2016).....	17
Tabela 8: Pasqyra e potencialit total të kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të komunës	20
Tabela 9: Karakteristikat teknike te ndërtesave administrative	22
Tabela 10: Karakteristikat teknike të ndërtesave arsimore	22
Tabela 12: Pasqyra e potencialit total të kursimit të energjisë në sektorin e ndriçimit publik	24
Tabela 13: Potenciali i përgjithshëm i kursimit të energjisë	24
Tabela 14: Projektet investive me prioritet në komunën e Hani i Elezit.....	25
Tabela 15: Investimet e planifikuara me masat EE në buxhetin e Komunës së Hani i Elezit (në miliona Euro)	26

Figurat

Figura1: Organogrami i Komunës së Hani i Elezit	11
Figura 2. Shpenzimet komunale për lëndë djegëse dhe energji elektrike, Hani i Elezit 2016	13
Figura3: Përdorimi i lëndëve djegëse në ndërtesat komunale (MWh).....	18
Figura4: Shpërndarja e ndërtesave publike komunale sipas konsumit specifik të energjisë (shembull)	18
Figura5: Krahasimi i konsumit mesatar specifik të energjisë për ndërtesat e përzgjedhura në pronësi komunale në Kamenicë	20

Shkurtesat

EE	-	Efiçienca e Energjisë
ZBE	-	Zyra e Bashkimit Evropian
GIZ	-	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
AKEE	-	Agjencia e Kosovës për Efiçiençë të Energjisë
kWh	-	kilovat orë
ktoe	-	" <i>kiloton oil equivalent</i> " (kiloton ekuivalent i naftës)
k Euro	-	kilo-Euro (mijëra Euro)
kWh/m ² *v	-	kilovat orë për metër katror në vit (njësi për KSE)
LED	-	Ndriçimi me Dioda Emetuese (teknologjia e ndriçimit efikas të energjisë)
PKVEE	-	Plani Komunal i Veprimit të Efiçiençës së Energjisë
PKEE	-	Plani Komunal i Efiçiençës së Energjisë
MWh	-	Megavat orë
NI	-	Asnjë informacion (në dispozicion)
NA	-	Nuk aplikohet
PNVEE	-	Plani Nacional i Veprimit për Efiçiençën e Energjisë
PVEQ	-	Plani i Veprimit për Energji të Qëndrueshme
KSE	-	Konsumi Specifik i Energjisë (energji e përdorur për metër katror në vit)

1. HYRJE

Plani Komunal i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (më tej: PKVEE) i Komunës së Hani i Elezit synon që:

- përmes vlerësimit të konsumit të energjisë në Komunën e Hani i Elezit, të identifikoj sektorët prioritarë për ndërhyrje me qëllim të rritjes së eficiencës së energjisë në territorin e saj,
- të vlerësojë potencialin e kursimit të energjisë në komunë dhe të caktojë objektivat për kursimin e energjisë,
- të identifikojë një listë të projekteve prioritarë për investime,
- të identifikojnë modelet e financimit të projekteve,
- të përshkruaj një strukturë institucionale për zhvillimin dhe implementimin masave të kursimit të energjisë që do të zbatohen, si dhe monitorimin/raportimin pas implementimit të tyre.

1.1 KONTEKSTI

Bazuar në Direktivën për Eficiencën e Energjisë 2012/27/BE, që ka hyrë në fuqi më 5 dhjetor 2012, Bashkimi Evropian ka vendosur objektiva për reduktimin e konsumit të energjisë primare në 20% deri në vitin 2021. Republika e Kosovës si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë është përcaktuar të kontribuoj në arritjen e objektivave të eficiencës së energjisë, duke krijuar stimuj për kursimin e energjisë nga qytetarët, gjithashtu për hapjen e tregjeve dhe bizneseve të reja për aplikimin e teknologjive dhe shërbimeve efikase për energji.

Plani i përcaktuar i Veprimit për Eficiencë të Energjisë (2010-2018) u miratua nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik më 30 shtator 2011. Ai siguron një objektiv indikativ për arritjen e caktuar 9% të 1,021.08ktoe deri në fund të periudhës së përfshirë me planin (2010-2018). Pra, objektivi mbetet në fuqi deri në vitin 2018 se Kosova duhet të kursej 91.89 ktoe.

Aktivitetet në nivel lokal luajnë një rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të lartpërmendura në nivel kombëtar.

1.1.1 Kuadri ligjor dhe politik

LIGJI PËR EFIÇIENCËN E ENERGIJË (Ligji Nr. 04 / L-016), miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në qershor 2011 - Neni 9 përshkruan përgjegjësitë e Zyrave Komunale të Energjisë në zhvillimin e Planeve Komunale të Eficiencës së Energjisë dhe Raporteve të Progresit të Zbatimit të Planit Komunal të Eficiencës së Energjisë, sipas udhëzimeve të Agjencionit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë-AKEE. Të dy dokumentet duhet të miratohen nga Kuvendi Komunal dhe më pas të dorëzohen në AKEE.

LIGJI PËR ENERGIJË - Neni 4 thotë se Qeveria do të nxjerrë akte nënligjore për themelimin, financimin dhe funksionimin e zyrave komunale të energjisë, të cilat do të adresojnë çështjet që lidhen me zbatimin dhe monitorimin në nivel lokal.

UDHËZIM ADMINISTRATIV (QRK) Nr. 09/2017, datë 6 shtator 2017, PËR ZYRAT E ENERGIJË KOMUNALE - përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e zyrave komunale të energjisë për të adresuar çështjet e planifikimit, zbatimit dhe monitorimit të politikave energjetike në nivel lokal. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë e tjera të Zyrave Komunale të Energjisë më poshtë janë shënuar përgjegjësitë kryesore:

- të krijojë një bazë të dhënash dhe të mbajë një sistem informacioni për grumbullimin e rregullt të të dhënave për konsumin e energjisë në baza periodike, shpenzimet e energjisë dhe të dhëna të tjera relevante duke mbajtur një regjistër që mundëson përzgjedhjen e indikatorëve potencial të efikasitetit të energjisë për ndërtesat komunale energjetike,
- të raportojë për zbatimin e PKVEE, dhe zhvillimet e pritshme në pjesën e mbetur të Programit,
- të zhvillojë aktivitetet e planifikimit të sektorit të energjisë, bazuar në Strategjinë e Energjisë, për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të komunave,
- të sigurojë të dhënat e nevojshme për Ministrinë përkatëse për përgatitjen e PKVEE-it, rishikimin dhe përgatitjen e Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë për tre (3) vjet në pajtim me Ligjin për Energjinë,
- të monitorojë vazhdimisht zbatimin e PKVEE në nivelin komunal dhe t'i raportojë Ministrisë për zbatimin e tij.

1.1.2 Objektivat dhe përfitimet nga PKVEE

Objektivi i përgjithshëm i PKVEE është zvogëlimi i konsumit të energjisë, rritja e nivelit të rehatisë dhe ulja e barrës së shpenzimeve të energjisë në buxhetin komunal të Komunës së Hani i Elezit.

Në gjendjen e Komunës së Hani i Elezit pritet që PKVEE të ketë ndikimet e mëposhtme:

- Zvogëlimi i konsumit të energjisë në sektorët e ndërtimit të ndërtesave, transportit dhe ndriçimit publik;
- Reduktimi i kostove të energjisë në buxhetin komunal;
- Përmirësimi i shërbimeve komunale;
- Renovimet e ndërtesave dhe instalimeve për prodhim të energjisë;
- Përmirësimi i kushteve sanitare dhe nivelit të rehatisë (komfortit) në ndërtesat publike;
- Zvogëlimi i emetimeve të CO₂ në të gjithë sektorët duke zbatuar masat e efikasitetit të energjisë, duke përdorur burimet e ripërtëritshme të energjisë, duke menaxhuar konsumin, përmes trajnimit dhe masave të tjera;
- Ngritja e vetëdijes e kreatorëve të politikave për kursim të energjisë, operatorëve dhe përdoruesve përfundimtarë.

Përfitimet që priten nga zbatimi i PKVEE janë:

- Përfitimet financiare,
- Përfitimet operacionale, duke përfshirë përmirësimin e klimës së brendshme,
- Përfitimet mjedisore.

1.2 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

PKVEE jep informacion mbi konsumin e energjisë në stokun e ndërtesave komunale - ndërtesat administrative, arsimore dhe shëndetësore, në sektorin e ndriçimit rrugor si dhe për flotën komunale të automjeteve dhe ndërtesave të ndermarrjeve publike komunale të shtrira mbrenda kufijve të komunës.

Komuna e Hani i Elezit ka zbatuar disa projekte të rinovimit me masat EE - përmirësimin e izolimit termik të fasadave të ndërtesave, ndërrimin e dritareve, ndërrimin e ndriçimit publik me LED.

Analiza e stokut të ndërtesave komunale dhe shërbimeve të ndriçimit rrugor tregon se potenciali i përgjithshëm i kursimeve të energjisë në Komunën e Hani i Elezit është vlerësuar të jetë 249MWh në vit.

PKVEE për Komunën e Hanit të Elezit (2019-2021)

Tabela1: Pasqyra e potencialit të kursimeve të energjisë në Komunën e Hanit të Elezit

	Konsumi i energjisë (2016) MWh/vit ¹	Shpenzimet e konsumit të energjisë (2016) ²	Potenciali për kursim MWh/vit	Potenciali për kursim %
Spektori i Ndërtesave Komunale	1,236 ³	€ 20,605.00 ⁴ Euro	213 ⁴	29% ⁵
Spektori i Ndrçimit Rrugor	80	€ 30,577.00 ⁶ Euro	36 ⁷	50% ⁸
Flota Komunale e Automjeteve	144	€ 10,184	-	-
Kompanitë Publike në Komunë	NA	NA	-	-
Gjithsej	1,460	61,182 €	249	

Në bazë të asaj që Han i Elezit është një komunë relativisht e vogël lista e projekteve investimeve prioritare përfshin (vetëm) 1 projekt me një kursim të përgjithshëm të energjisë prej 10MWh/vit dhe investime që kërkojnë së paku 15,000 euro.

¹ Te dhenat e PKVEE janë mbledhur në TM 4 të 2017 dhe është hartuar në periudhën 2017-2018 dhe te dhenat në dispozicion kanë qenë vetëm ato të vitit 2016. PKVEE duhet të përditesohet në baza të rregullta vjetore nga komuna.

² Te dhenat e PKVEE janë mbledhur në TM 4 të 2017 dhe është hartuar në periudhën 2017-2018 dhe te dhenat në dispozicion kanë qenë vetëm ato të vitit 2016. PKVEE duhet të përditesohet në baza të rregullta vjetore nga komuna

³ Për të gjitha ndërtesat komunale të raportuara për vitin 2016

⁴ Kursimet për ndërtesat e komunës të përfshira në analizë (p.sh. për ato të cilave l'u dihet sipërfaqja dhe konsumi i energjisë dhe për ndërtesat me mbi 80 kWh/m²*v)

⁵ Përqindja e kursimeve vetëm për ndërtesat e komunës të përfshira në analizë

⁶ Shpenzimet e raportuara në Euro nga Komuna për ndriçimin rrugor për vitin 2018 janë 30,577.00 Euro

⁷ Për llambat e mbetura të ndriçimit publik ende jo me teknologjinë LED.

⁸ Në lidhje me konsumin e energjisë të llambave që raportohet të jenë pa teknologji LED

PKVEE për Komunën e Hani i Elezit (2019-2021)

Tabela2: Lista e projekteve për investimet prioritare

#	Emri i objektit	Lloji	Konsumi (2016 ⁹) MWh/vit	Potenciali i kursimeve MWh/vit %	Investimet ne mije Euro
1	Ndërrimin e ndriçimit publik në zonat urbane dhe rurale dhe njëherit të zëvendësohet me LED	Sektori i ndriçimit rrugor	80 ¹⁰	>36	15,000-30,000

Për përzgjedhjen e projekteve prioritare të investimeve për efikasitet të energjisë, komuna, e cila ka vetëm një numër të vogël ndërtesash komunale, ka zgjedhur ndërrimin e ndriçimit publik në zonat urbane dhe rurale dhe njëherit të zëvendësohet me LED.

Megjithatë, të dhënat e raportuara janë vlerësimet e para, prandaj edhe duhet të kontrollohen dhe detajohen dhe të përgatiten plani i investimit.

2. INFORMACIONET BAZË PËR KOMUNËN

Hani i Elezit (Shqip: Hani i Elezit; Serbisht: Elez Han) është një qytezë dhe komunë që gjendet në rajonin e Ferizajit në Kosovë.

2.1 POPULLSIA DHE VENDBANIMET

Që nga viti 2011, Hani i Elezit ka një popullsi prej 9,403 banorëve (qyteza e Hani i Elezit: 2,533). Ajo mbulon një sipërfaqe prej 82.9km², dhe përbëhet nga një qytezë dhe 10 fshatra (2 nga fshatrat nuk janë të banuara, burimi: Censusi 2011).

Tabela3: Zonat e populluara të komunës së Hani i Elezit (2015)

Zonat e populluara	Numri i banorëve
82.9 km ²	9,403

Burimi i informatës – Faqja zyrtare e internetit e Komunes se Hanit te Elezit

⁹Te dhënat e PKVEE janë mbledhur në TM 4 të 2017 dhe është hartuar në periudhën 2017-2018 dhe të dhënat në dispozicion kanë qenë vetëm ato të vitit 2016. PKVEE duhet të përditesohet në baza të rregullta vjetore nga komuna

¹⁰Shpenzimet e raportuara në Euro nga Komuna për vitin 2018 janë 30,577.00 Euro.

2.2 STRUKTURA ORGANIZATIVE

Struktura organizative e Komunës së Hani të Elezit është paraqitur në organogramin e mëposhtëm.




Figura1: Organogrami i Komunës së Hani të Elezit

Burimi i informatave – Komuna Hani i Elez

Komuna e Hanit të Elezit ende nuk ka emëruar Menaxher të Energjisë. Të dhënat në këtë dokument janë siguruar nga z. Kujtim Dernjani, Zyrtar në Departamentin e Shërbimeve Publike.

2.3 TREGUESIT EKONOMIK DHE FINANCIAR

Në Han të Elezit ekzistojnë dy kompani të mëdha:

- Fabrika e çimentos Sharr-Cem
- Kosovaplast (fabrika e pllantikës),

Të gjitha këto më lart ishin pjesë e Kombinatit të Sharrit para vitit 1989. Sharr-Cemkishte të punësuar rreth 770 persona, Salonit 280 punëtorë dhe Kosovaplast kishte 100 të punësuar. Pjesa e mbetur e forcës së punës zhvillon biznes privat ose punon në sektorin bujqësor.

Tabela4: Buxheti i Komunës së Hani i Elezit (Euro)

Hani i Elezit	2019
Buxheti total	€ 2,915,921
Fatura e përgjithshme e energjisë për vitin 2018 ¹¹	€61,367.15 EUR
Ndërtesat publike – (përfsh. Ene. elektrike) ¹²	20,605.85 EUR
Ndriçimi publik ¹³	30,577.30EUR
Automjetet e komunës (karburantet)	€ 10,184
Investimet TOTALE për masat e EE	NA
Kontributi i drejtpërdrejt nga buxheti i Komunës	€ 0

Burimi i informatave – komuna Hani i Elezit

Komuna e Hanit të Elezit ka shpenzuar afërsisht 2.4% të buxhetit të saj për të mbuluar kostot e energjisë. Shpenzimet llogariten duke përdorur konsumin e energjisë të raportuar nga komuna dhe çmimet mesatare specifike të karburanteve dhe energjisë elektrike.

Aktualisht, një sasi e konsiderueshme e drurit (shih më poshtë se çfarë përdor komuna në baza vjetore), nuk blihet nga komuna, por konfiskohet nga prerjet ilegale te pyjeve.

¹¹Fatura e përgjithshme e energjisë për vitin 2018 e raportuar nga Komuna ne Shkurt 2019 eshte 61,367.15 EUR

¹²Shpenzimet e raportuara ne Euro nga Komuna per vitin 2018 jane 20,605.85 EUR – Raportuar ne Shkurt 2019.

¹³Shpenzimet e raportuara ne Euro nga Komuna per vitin 2018 jane 30,577.30EUR – Raportuar ne Shkurt 2019

Shpenzimet komunale për lëndë djegëse, karburante dhe energji elektrike për vitin e kaluar raportues mund të gjenden në grafikun e mëposhtëm.




Figura2. Shpenzimet komunale për lëndë djegëse dhe energji elektrike, Hani i Elezit 2016

2.4 PËRMBLEDHJE E PROJEKTEVE PËR EE TË ZBATUARA NË KOMUNË

Në vitet e fundit, komuna e Han i Elezit ka zbatuar projektin e mëposhtëm për të përmirësuar efikasitetin energjetik të stokut të ndërtesave komunale dhe/ose ndriçimin publik, shih tabelën më poshtë.

Tabela5: Projektet e EE te zbatuara në 3 vitet e fundit në Komunën e Hani i Elezit

Objekti	Masat/viti i zbatimit tëEE	Vlera financiare totale	Kursimet e arritura të energjisë	Implementuar
Renovimi i objektit të komunës në Han të Elezit	Aplikimi i izolimit termik (1,140 m2)	€193,630	NA	E kryer ne 2015
Renovimi i objektit të shkollës së mesme "Dardania"	Aplikimi i izolimit termik dhe dritare me xhama të dyfisht	€9,497.75 (pjesa e parë)	NA	E kryer në 2012 dhe 2017
Renovimi(rregullimi)i ambulantës në fshatin Gorancë	Aplikimi i izolimit termik dyert dhe dritare me xhama të dyfisht dhe punë të tjera në kuadër të efiqencës së energjisë	€ 6,664.00	NA	E kryer në vitin 2017

Burimi – AKEE Mars 2018 per ndriçimin me LED dhe projektet e renovimit

3. ANALIZA E KONSUMIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të energjisë në ndërtesat publike të Komunës së Hanit të Elezit u siguruan nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Ndërmarrje Publike përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave publike. Cilësia e të dhënave të ofruara në përgjithësi është e mirë.

3.1 KONSUMI I ENERGJISË NË SEKTORIN E NDËRTHESAVE PUBLIKE KOMUNALE

Analiza e të dhënave për konsum specifik të energjisë të ndërtesave tregon se konsumi i energjisë i raportuar në të gjitha ndërtesat publike komunale luhatet nga vlera minimale prej 38kWh/m² në vit deri në 481kWh/m² në vit (për konsum në vitin 2016), ndërsa për ndërtesa tjera, nuk janë raportuar të dhënat e konsumit të energjisë.

Në mënyrë që të kemi një analizë të mirë të stokut të ndërtesave, ndërtesat e renditura ne kategoritë e mëposthme do të përjashtohen për analiza të mëtejshme nëse plotësohen tre treguesite mëposhtëm:

1. Ndërtesat për të cilat nuk janë ofruar informacione për sipërfaqen e përgjithshme që ngrohet dhe nuk janë ofruar të dhëna për konsumin e lëndëve djegëse për prodhimin e ngrohjes;
2. Ndërtesat me vlera të ulëta të konsumit specifik të energjisë, më pak se 80 kWh/m², të cilat do të tregojnë se ndërtesa të tilla tashmë ishin mjaft eficiente;
3. Ndërtesat me vlera shumë të larta të konsumit të energjisë, më shumë se 400 kWh/m², të cilat mund të tregojnë se të dhënat janë të pasakta (gabimet në të dhëna). Së pari duhet të hetohen të dhënat e disponueshme të konsumit të energjisë të këtyre ndërtesave.

Tabela6: Pasqyra e ndërtesave të përjashtuara nga analiza e mëtutjeshme

<p>Pjesa A: Lista e Ndërtesave për të cilat nuk janë ofruar informacione për sipërfaqen e përgjithshme ngrohëse dhe nuk janë ofruar të dhëna për konsumin e lëndëve djegëse për prodhimin e ngrohjes (për vitin 2017):</p>		
1. Edukim	Shkolla fillore	Laq
2. Edukim	Shkolla fillore	Pustenik (shih shenimet)
3. Administrata	Komuna	QPS
4. Administrata	Komuna	Pylltari
5. Administrata	Komuna	Shtëpi e zjarrfiksëve
6. Shtëpi e kulturës		
<p>Pjesa B: Lista e Ndërtesave për të cilat konsumi specifik i energjisë është shumë i ulët:</p> <p>Më ulët se 50 kWh/m²*vit:</p>		
1. Edukim	Shkolla fillore	„Kështjella e Diturisë-Paldenicë
<p>Pjesa C: Lista e Ndërtesave për të cilat konsumi specifik i energjisë është shumë i lartë</p>		
1. Ambulanc	Shtëpi e shëndetit	Menduh Kaloshi Hani Elezit
2. Ambulanc	Shtëpi e shëndetit	Menduh Kaloshi Gorance

Në total, 9 ndërtesa janë përjashtuar nga analiza e mëtejshme qoftë nëse për ato konsumi i veçantë i energjisë është jashtë brezit specifik (1 nën 50kWh/m² *vit dhe dy ndërtesa tjera për arsyeje të konsumit shumë të lartë (mbi 400 kWh/m² *vit). 6 ndërtesa tjera janë të përjashtuara, pasi që nuk kishte të dhënë për hapsirën, dhe konsumit të energjisë, Shikoni arsyetimin për këtë metodologji në shtojcën 2 të këtij dokumenti.

Prandaj, nëse përqendrohemi në potencialin e efijencës së energjisë, në gjithsej 7 nga 16 ndërtesa ose 44% të stokut të ndërtesave në Hani i Elezit ka shumë gjasa të sigurohen kursime të mira ose madje edhe të konsiderueshme të energjisë.

Prandaj, nëse përqendrohemi në potencialin e efijencës së energjisë, në gjithsej 58 nga 68 ndërtesa ose 85% e stokut të ndërtesave në Hanin e Elezit, ka shumë gjasa të sigurohen kursime të mira ose madje edhe shumë të konsiderueshme të energjisë.

Duke marrë parasysh këtë, për nevojat e analizës së konsumit të energjisë, stoku i ndërtesave në pronësi të Komunës së Hani i Elezit ndahet në 4 kategoritë e mëposhtme:

- Ndërtesa administrative,
- Ndërtesa arsimore,
- Ndërtesat e kujdesit të mjekësisë familjare,
- Ndërtesa kulturore dhe sportive.

Ndarja e stokut të ndërtesave komunale në kategoritë e lartpërmendura është bërë me qëllim që të merret njohuria më e saktë e konsumit aktual të energjisë termike dhe elektrike në nën sektorin e ndërtesave në pronësi të Komunës së Hani i Elezit.

3.1.1 Ndërtesat administrative

Është 1 ndërtesë administrative e raportuar nga Komuna e Hani të Elezit me një sipërfaqe totale ngrohëse prej 1,141 m².

Konsumi total i raportuar i energjisë në këto ndërtesa administrative të Komunës së Hani të Elezit në vitin 2016 ishte 147 MWh.

Analiza e të dhënave tregon se konsumi total i energjisë specifike për ndërtesën e vetme administrative të zgjedhur është 129 kWh / m².

3.1.2 Ndërtesat arsimore

Janë 6 ndërtesa arsimore me potencial të mirë deri në shumë të mirë të kursimit të energjisë në Komunën e Hani të Elezit me një sipërfaqe totale për ngrohje prej 5,878 m², të ndara në tri kategori:

- Shkollat fillore të mesme të ulëta - 5 ndërtesa, sipërfaqja e përgjithshme 3,910 m²
- Shkollat e mesme - 1 ndërtesë, sipërfaqja e përgjithshme 1,968 m²

Konsumi i energjisë në ndërtesat nën-sektoriale të arsimit të Komunës së Hani i Elezit në vitin 2018, ishte 645 MWh, që jep konsumin specifik prej 110 kWh/m²

Analiza e të dhënave tregon se, konsumi specifik i përgjithshëm i energjisë luhatet nga 81 kWh/m² në 230 kWh/m².

3.1.3 Ndërtesat e kujdesit mjekësor familjar

Nuk ka ndërtesa shëndetësore të raportuara nga Komuna e Hani i Elezit e cila ofron mundësi për të kursyer energji.

3.1.4 Ndërtesat e kulturës dhe sportit

Nuk ka ndërtesa kulturore dhe/ose objekte sportive të raportuara nga Komuna e Hani të Elezit e cila ofron mundësi për të kursyer energji.

3.2 SEKTORI I NDRIÇIMIT PUBLIK TE RRUGËVE

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të energjisë elektrike në sektorin e ndriçimit publik të Komunës së Hani i Elezit u bënë nga komuna, me shtesa nga AKEE.

Gjatësia totale e rrjetit të ndriçimit publik është raportuar të jetë 37.2 kilometra. Ndriçimi i rrugëve është siguruar për 31 rrugë të shpërndara mbi 7 seksione në Komunën e Hani i Elezit.

Rrjeti elektrik i ndriçimit publik në Komunën e Hani i Elezit përfshin 603 llamba. Të gjitha këto janë raportuar të jenë (në vitin 2016) të llojit HID metal halide. Në vitin 2017, komuna ka zëvendësuar 171 nga këto ndriçues me teknologji LED.

Konsumi i energjisë elektrike i sistemit të ndriçimit publik në vitin 2017 (2016: të dhëna jo të plota) ishte rreth 80 MWh (me të dhëna mungojnë për disa muaj / rrugë). Prandaj, konsumi i energjisë elektrike, duhet të zvogëlohet. Zvogëlimi mëtejshëm duhet të jetë i mundshëm duke zëvendësuar pjesën e mbetur me teknologjinë LED.

3.3 KOMPANITË PËR SHËRBIME KOMUNALE

Komuna e Hanit të Elezit ka raportuar për një kompani në pronësi komunale NPL PASTRIMI SHA. Vepron një ndërtesë të përbashkët në objektin e QPS-së tani më edhe kompania regjionale e Bifurkacionit me zyrën e saj në Han të Elezit ku ata bashkarisht operojnë në objektin e Qendrës për punë sociale, shfrytëzojnë nxemjen qendrore me dru, ku gjatë vititata djegin mbi 50m dru (ky objekt është objekt iri i ndërtuar në vitin 2012,2013,2014, me sipërfaqe ngrohëse prej 540 m²).

3.4 TRANSPORTI PUBLIK / PARKU I ATUMOJETEVE TË KOMUNËS

Komuna e Hani te Elezit nuk ofron shërbime publike të transportit dhe prandaj vetëm analiza e flotës te automjeteve të Komunës së Hani te Elezit.

Të dhënat relevante për analizën e konsumit të karburantit në flotën komunale janë mbledhur nga administrata e Komunës së Hanit të Elezit.

Flota e autmjete në pronësi të Komunës së Hanit të Elezit përfshin 14 automjete të përdorura nga komuna, qendrat shëndetësore familjare dhe zjarrfikësit.

Konsumi total i karburanteve të flotës të automjeteve komunale në vitin 2016 ishte 10,184 litra.

Tabela7: Konsumi i karburanteve për floten e automjeteve të komunës(2016)

Lloji i karburantit	Numri i automjeteve	Konsumi Litra
Dizel	14	10,184
Benzinë	0	NA
Gjithsej	14	10,184

Burimi i Informatave – Komuna e Hani i Elezit

Në përgjithësi, përveç emetimeve të karbonit, automjetet me karburant dizel tani njihen të kontribuojnë ndjeshëm në përkeqësimin e cilësisë së ajrit në zonat urbane sidomos emetimet e grimcave PM10.

4. PRODHIMI I ENERGJISË NGROHËSE PËR NDËRTE SAT PUBLIKE KOMUNALE

Janë gjithsej 16 ndërtesa publike komunale në nën sektorin e ndërtesave në pronësi të Komunës së Hani të Elezit dhe të përfshira në analizë, me një sipërfaqe totale të ngrohëse prej 11 937 m². Bazuar në të dhënat e komunës, këto ndërtesa konsumuan në vitin 2016:

- Pa qymyr
- 620 m³dru
- Zerpelet druri
- Nuk perdoret naftë për prodhimin e ngrohjes.

Përfshirë energjinë elektrike (95 MWh, e cila gjithashtu mund të përdoret për ndriçim dhe pajisje elektrike), lëndat djegëse më e rëndësishme e përdorur për ndërtesat komunale në Hani të Elezit është druri me pjesëmarrje prej 92%, ndjekur nga energjia elektrike me 8%. Shih gjithashtu grafikun më poshtë.




Figura3: Përdorimi i lëndëve djegëse në ndërtesat komunale (MWh)

5. ANALIZA E POTENCIALIT TË EFIKASITETIT TË ENERGJISË SIPAS SEKTORËVE


Vlerësimi i potencialit të efikasitetit të energjisë është bërë në dy sektorë kryesorë që janë nën kontrollin e plotë të Komunës së Hani të Elezit - sektori i ndërtesave publike komunale dhe sektori publik i ndriçimit rrugor.

5.1 SEKTORI I NDËRTESAVE PUBLIKE KOMUNALE

Vlerësimi i potencialit të efikasitetit energjetik të ndërtesave me konsum specifik të energjisë më të lartë se 80 kWh/m², janë marr në konsideratë për zbatimin e masave të EE. Në tërësi ka 9 ndërtesa publike komunale me një konsum të tillë, pra me të lartë se 80kWh/m², specifik të energjisë në Komunën e Hani të Elezit (nga 16 të përfshira në analizë), me një potencial total të kursimit për këto 9 godina komunale prej 1,694 MWh në vit, me potencial mesatar të kursimit 29%.

Figura4: Shpërndarja e ndërtesave publike komunale sipas konsumit specifik të energjisë (shembull)

PKVEE për Komunën e Hani i Elezit (2019-2021)



PKVEE për Komunën e Hani i Elezit (2019-2021)

Tabela8: Pasqyra e potencialit total të kursimit të energjisë në stokun e ndërtesave të komunës

#	Ndërtesa	Sipërfaqja që ngrohet m ²	Konsumi specifik i energjisë kWh/m ²	Vlera e caktuar kWh/m ²	Potenciali i kursimit të energjisë kWh/vit
1	Ndërtesa e Komunës Hani i Elezit	1,141	129	80	55,907
2	Shkolla Fillore Ilaz Thaçi Hani i Elezit	4482,78	103	80	56,380
3	Shkolla Fillore Veli Ballazhi-Gorancë	975	140	80	58,211
4	Shkolla e Mesme Shml Dardania-Hani i Elezit	1,968	81	80	2,575
5	Shkolla Fillore Seqisht	426.27	208	80	36,510
6	Shkolla Fillore Krivenik	115.40	163	80	9,531
7	Shkolla Fillore Rezhancë	80	230	80	12,020

Struktura e konsumit total të energjisë sipas kategorive të ndërtesave në pronësi të Komunës së Hani i Elezit është paraqitur në figurën tjetër.

Specific Energy Consumption (Hani i Elezit)




Figura5: Krahasimi i konsumit mesatar specifik të energjisë për ndërtesat e përzgjedhura në pronësi komunale në Kamenicë

Nga krahasimi i konsumit specifik të energjisë, është e qartë se ekzistojnë dallime në mes të kategorive të ndryshme, kështu që rekomandimi është që të fillohet të bëhen auditimet e energjisë në ndërtesat me konsumin më të lartë të energjisë – në sektorin e ndërtesave arsimore (si dhe një ndërtesë administrative).

Kriteret e përdorura për përzgjedhjen e ndërtesave prioritare për investime janë si më poshtë:

- Potenciali më i lartë i kursimit të energjisë,
- Qëndrueshmëria e investimeve - ndërtimi do të përdoret së paku për 10 vitet e ardhshme,

- E kanë të kryer auditimin e energjisë,
- Kanë potencial të mirë për promovimin e masave/dukshmërinë të EE.

Nga grupi i (9) ndërtesave të paracaktuara për rinovim, ne ofrojmë karakteristika themelore teknike për të përgatitur (më tej) përmirësimin e performancës së energjisë.

5.1.1 Ndërtesat administrative

Tabela9: Karakteristikat teknike te ndërtesave administrative

#	Ndërtesa	Viti i ndërtimit	Izolimi termik i ndërtesës fasada/viti	Xhamat e dyfishtë ne dritare/viti	Auditimi i energjisë	Konsumi specifik i nxehtësisë kWh/m ²
1	Ndërtesa e Komunës së Hani te Elezit	1956	Po	Po	Jo	129

